REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr.2627/1 Prot. Lushnje, më 21/03/2025

PROJEKT - VENDIM

NR. 33 DATË 21/03/2025

PËR NJË SHTESË NË VKB-NË NR 02 DATË 23/01/2025 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QË BANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2025 pasi analizoi relacionine paraqitur nga zyra e Strehimi dhe në zbatim të nenit 24, nenit 54 të ligjit Nr: 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", kreu V neni 33, 34, 35, 38, dhe të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin"dhe të VKB Nr.90datë 23.11.2023 "Mbi miratimin e sisitemit të pikëzimit për programin Subvencionimi i Qirasë "Këshilli Bashkiak.

PROPOZOJMË :

1. Të miratojë listën e subvencionimit të qirasë për familje te pastreha që banojnë me qiranë tregun e lirë dhe nuk kane të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vleren e qirasë për periudhën Mars - Dhjetor 2025, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit dhe Drejtoria e Financë- Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Kryetari i Bashkisë

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16 të ligjit nr. 22/2018	Adresa	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit	Qiraja mes.e apart.Në treg per strukturen qe i takon familjes	Të ardhura familjare mujore	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia
a	b	c	d	e	f	h	i	n
	Mustafa Xhaferr Latifi	-Banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje. -Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	"Kadri Qystri"	3	1+1	16,000	10,955	8,000

Drejtoria e Shërbimit Social

Anila Çela